



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas – Municipality of Drenas



Pranuar	03 02		
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
13.052/03.	6558		

PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK I DRAFT - PLANIT KOMUNAL MENAXHIMIN E MBETURINAVE 2023-2027



JANAR, 2023

INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

Duke duke u bazuar në Ligjin numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Drenasit 01 Nr.110-6904 dhe Nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Zyra për Informim në Komunën e të Drenasit, bën njoftimin për :

KONSULTIM PUBLIK

Për Draft-planin komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027

Me 11.01.2023, është publikuar njoftimi për mbajtjen e konsultimit për Draft-Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027. Njoftimi është publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës, përkatësisht tek kategoria për konsultimet publike si dhe në faqen zyrtare të Komunës së Drenasit në rrjetin social Facebook.

1. Publikimi në uebfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/glllogoc/news/njoftim-per-konsultim-pubik-per-planin-komunal-per-menaxhimin-e-mbeturinave-2023-2027/>

2. Publikimi facebook:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=658137752784154&set=a.397973495467249>

3. Publikimi në Platformën e Konsultimeve Publike:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41706>



REPUB LIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit/Glogoc
Zyra e Kryetarit
Nr. 01-030/01- 2254 dt: 11.01.2023

Komuna e Drenasit, përmes grupit punues për hartimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027, duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutit të Komunës së Drenasit (Glogocit), 01 Nr.110-6904 dhe Nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Komuna e Drenasit/Glogocit lëshon këtë:

NJOFTIM PUBLIK

Lidhur me organizimin e konsultimit publik me qytetarë për Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027

Ky dokument do të jetë në konsultim publik nga data 11.01.2023 deri më datën 25.01.2023, ndërsa konsultimi publik me qytetarë do të mbahet me datën 26.01.2023 në Sallën e Kuvendit të Komunës duke filluar nga ora 11:00.

Komentet dhe sugjerimet e juaja, mund t'i dërgoni deri më datën 25.01.2023 në ora 16:00 ne këto adresa; luminije.o.krapi@rks-gov.net dhe komuna.drenas@rks-gov.net

Për më shumë detaje për Draft-Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027, mund t'i vizitoni vegëzat e mëposhtme ku është publikuar ky draft dokument;

Ueb faqja zyrtare e Komunës në rubrikën Konsultimet Publike, ne këtë link:
<https://kk.rks-gov.net/glogoc/category/konsultimet-publike-al/>

Platforma për Konsultime Publike:
<https://konsultimet.rks-gov.net/consultationsList.php>

Rrjetin social të Facebook:
<https://www.facebook.com/komunadrenas>

Udhëheqës i Zyrtar për Komunikim dhe Publikim



Me 23.01.2023, në faqen zyrtare të Komunës së Drenasit në rrjetin social Facebook është publikuar rikujtimi i njoftimit për mbajtjen e konsultimit publik dhe në të njëjtën ditë kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve u është dërguar njoftimi edhe përmes telefonit

Më datë: 26.01.2023 mbahet konsultimi publik në sallën e Kuvendit Komunal.

Lajmin për mbajtjen e konsultimit mund të gjeni të publikuar në vegëzat:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=668267848437811&set=pcb.668268038437792>

<https://kk.rks-gov.net/glllogoc/news/mbahet-konsultimi-publik-per-draft-planin-komunal-per-menaxhimin-e-mbeturinave-2023-2027/>

Konsultimi publik filloi në orën 11:00, në sallën e Kuvendit Komunal të Drenasit.




Konsultimin e shpalli të hapur z.Bekim Dobra – Udhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun, për draft planin komunal për Menaxhimin e Mbeturinave , i cili citoi se ky dokument është i rëndësishëm që i hapë rrugë edhe Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave e cila është në konsultim publik më dt 27/01/2023. Njoftim është bërë me kohë 15 ditë përpara dhe ka qenë e publikuar në tri platformat kryesore në platformën e qeverisë (zyrën e Kryeministrit), në ueb faqen zyrtare dhe në rrjetin social facebook të Komunës siç janë të përcaktuar në bazë të dispozitave ligjore të cilat procedura se si

duhet të bëhet një konsultim publik edhe në bazë të udhëzimit administrativ për Standarde Minimale të Konsultimit Publik me Nr.06/2018 .

Për faktin se dokumenti ende është draft ju mund të jepni komentet, sugjerimet dhe rekomandimet e juaja në mënyrë që ato të inkorporohen në këtë draft plan pasi që ende nuk është miratuar ,sepse që në momentin që miratohet në Kuvendin Komunal atëherë është i zbatueshëm.

Fillimisht fjala i kalohet drejtoreshë e Shërbimeve Publike znj.Lumnije Krapit.



Znj.Krapit falënderoi të gjithë të pranishmit të cilët kanë gjetur kohë të jenë pjesë në konsultimin publik të draft dokumentit të Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave, gjithashtu pas këtij prezantimi të këtij draft dokumenti, ndjehuni të lirë dhe mirëpresim çdo koment, sugjerim të vlefshëm që mund të inkorporojmë në draft planin komunal për menaxhimin e mbeturinave para se të shkohet në Kuvend Komunal për miratim. Përmes këtij draft dokumenti synojmë që të avancohet procesi i Menaxhimit të Mbeturinave që është në kompetencë të Komunës e përcaktuar në nenin 17 në ligjin për vetëqeverisje lokale. Për procesin e hartimit të planit komunal të Menaxhimit të Mbeturinave falënderoi grupin punues i cili ka qenë

i formuar nga ekspertë e drejtorive të fushave përkatëse, Gizin dhe OJQ CDE.

Aktivitetet e grupit punues kanë qenë të ndërlidhura përmes punësitorive dhe diskutimeve në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Gizin, ku është zhvilluar një proces i analizës për të formësuar vizionin e planit. Në planin ekzistues të Menaxhimit të mbeturinave janë kryesisht rezultatet dhe arritjet e objektivave të përgjithshme të planit komunal për vitet 2015-2021 ku Komuna e Drenasit ka arritur në realizimin e të gjitha objektivat që kanë qenë të planifikuar në mandatin 5 vjeçar si :

- Mbulueshmëria e shërbimeve në tërë territorin e Komunës së Drenasit;
- Shkalla e inakasimit mbi 87%;
- Largimi i 137 deponive ilegale;
- Procesi i ndarjes së mbeturinave që është filluar me procesin e kompostimit shtëpiak.

Draft plani i Menaxhimit të Mbeturinave përmban 5 objektivat kryesore të cilat brenda afatit 5 vjeçar pritet implementimi dhe avancimi i tyre .

Këto objektiva janë

- Parandalimi dhe minimizimi i gjenerimit të mbeturinave;
- Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave;
- Ofrimi i shërbimeve cilësore, efektive dhe efikase të shërbimeve
- Eliminimi i deponive ilegale;

- Zhvillimi i kapaciteteve institucionale për menaxhim të mbeturinave.

Për prezantim më të detajuar të planit për Menaxhimin e Mbeturinave fjala do ti kalohet kryesuesit të grupit punues z.Afrim Prokshi.



Z.Prokshi falënderoi të gjithë të pranishmit ku theksoi se Plani Komunal i Menaxhimit të Mbeturinave (PKMM) i Gllogocit është dokument planifikimi për zbatimin e Strategjisë së Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Planin e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave në nivel lokal, duke kontribuar në zbatimin e politikave dhe përmbushjen e objektivave të strategjisë. Përmes PKMM-së, komuna mundëson një qasje të menaxhimit të integruar të mbeturinave, duke zbatuar një sërë

masash, ku synimi kryesor është reduktimi i mbeturinave komunale që gjëndërohen në burim, ngritja dhe zhvillimi i infrastrukturës për trajtimin e mbeturinave, aspektet financiare të sistemit, aspekte tjera siç janë monitorimi i gjendjes në këtë sektor, bashkëpunimi me të gjithë akterët, ndërgjegjësimi i popullatës . Po ashtu theksoi se detyrimet dhe përgjegjësit e Komunës që rrjedhin nga ligji për menaxhim të mbeturinave 04/L-060 , prandaj jemi munduar që këto përgjegjësi të përfshihen në këtë plan. Draft plani për menaxhimin e mbeturinave përfshin edhe përcaktimin e modelit të operimit ku janë propozuar katër modele :

- Mbështetja e njësive të Kompanisë nga Komuna;
- Decentralizimi i kompanisë nga njësia qendrore në aspektin financiar;
- Krijimi i ndërmarrjes publike lokale;
- Partneriteti publiko-privat.

Z. Prokshoi theksoi se draft plani për menaxhimin e mbeturinave është i hartuar në atë formë që ti përmbushë edhe 5 objektivat kryesore të cilat janë:

- Objektivi 1 Parandalimi dhe minimizimi i gjenerimit të mbeturinave
- Objektivi 2 Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave
- Objektivi 3 Ofrimi i shërbimeve cilësore, efektive dhe efikase të shërbimeve
- Objektivi 4 Eliminimi i deponive ilegale

Objektivi 5 Zhvillimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e mbeturinave

z.Prokshi e laboroi në pika të shkurta të gjitha objektivat e parapara në këtë plan duke përfshirë të gjitha masat dhe aktivitetet e parapara në këto objektiva.

- **Objektivi 1 : Parandalimi dhe minimizimi i gjenerimit të mbeturinave janë të parapara këto aktivitete dhe masa si më poshtë:**
 - Mbeturina të grumbulluara për kokë banori (kg /ditë);
 - Riorganizimi i shërbimit për të mundësuar matjen e mbeturinave të grumbulluara;
 - Zbatimi i tarifave volume trike;
 - Futja e pakos stimuluese;
 - Shpërndarja e komposterëve individual;
 - Zbatimi i fushatës informative për parandalimi dhe minimizim të gjenerimit të mbeturinave.
- **Objektivi 2 : Ripërdorimi dhe riciklimi i tyre – në këtë objektivë janë të parapara këto masa dhe aktivitete :**
 - Studimi i gjenerimit dhe kompozicionit të mbeturinave komunale;
 - Studimi i fizibiliteti për modelin e operimit te qendrës se grumbullimit dhe ripërdorimit;
 - Zgjerimi i infrastrukturës ndarëse të mbeturinave në burim;
 - Riciklimi i mbeturinave të riciklueshme jo-degraduese;
 - Riciklimi i mbeturinave bio-degraduese;
 - Kontraktimi i operatorit të licencuar për grumbullimin dhe transportin dhe riciklimin e mbeturinave bio degraduese;
 - Studimi i fizibiliteti për modelin e operimit të qendrës së grumbullimit dhe ripërdorimit
 - Funksionalizimi i deponisë së MND;
 - Studimi i fizibilitetit për modelin e operimit te grumbullimit, transportimit dhe riciklimin te MND ne komune;
 - Kontraktimi i operatorit privat për MND;
 - Kontraktimi i operatorit privat për grumbullimin dhe transportin dhe riciklimin e mbeturinave të riciklueshme jo degraduese.
- **Objektivi 3 : Ofrimi i shërbimeve cilësore ,efektive edhe efikasiteti i shërbimeve - në këtë objektivë janë të parapara këto masa dhe aktivitete:**
 - Mbulimi me shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale;
 - Plani i ri operativ për shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale;
 - Digjitalizimi i sistemit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave;
 - Marrja përsipër e faturimit dhe arkëtimit nga komuna për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave;
 - Zgjidhja e statusit të rasteve sociale;
 - Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve në shërbim të mbeturinave.

- **Objektivi 4 : Eliminimi i deponive ilegale** – në këtë objektive janë të parapara këto masa dhe aktivitete :
 - Pastrimi i vend hedhjeve ilegale të mbeturinave;
 - Fushatë informuese;
 - Inspektim dhe monitorim.
- **Objektivi 5 : Zhvillimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e mbeturinave** , në këtë objektive janë të parapara këto masa dhe aktivitete:
 - Revidimi i RrK të MM;
 - Emërimi i zyrtarit / Formimi i njësitit;
 - Kalimi i procesit tariforë;
 - Kontraktimi i operatorit për grumbullim dhe transport të mbeturinave komunale;
 - Programi i trajnimit dhe mbështetjes së proceseve për komunën dhe operatorët.

Pas përmbylljes së perceptimit nga kryesuesi i grupit punues , atëherë z.Dobra hapi debat lidhur me propozimet dhe komentet që kanë qytetarët lidhur me PKMM.

Hapim debatin për këtë dokument dhe kushdo që ka ndonjë koment apo edhe sugjerim ta marrë fjalën.

Komentet dhe sugjerimet tuaja, anëtarët e grupit punues do t'i trajtojnë me kujdes dhe më pastaj do të vendosin nëse do t'i inkuadrojnë në dokumentin final.



Nebih Bajraktari – Administrator i Drenasit III : Përshëndetje për të gjithë, ju faleminderit për ftesën, në kuadër të diskutimit për planin e menaxhimit të mbeturinave kërkojë që të rritet kapaciteti i kompanisë, në mënyrë që itinerari i kompanisë të zbatohet në grumbullimin e mbeturinave, sepse në të kundërtën po krijohen depone ilegale .

Fitore Shabani - Kryesuese e komunitetit konsultativ për mbrojtjen e mjedisit– Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar dhe të respektuar, draft plani I menaxhimit të mbeturinave është një dokument shumë i rëndësishëm për Komunën mirëpo dua të dijë se përmes këtij dokumenti strategjik a e keni paraparë vetëdijesimin e qytetarëve dhe reduktimin e mbeturinave.

Murat Elshani - Administrator i fsh.Gllobar : Përshëndetje për të gjithë, e vlerësojë jashtëzakonisht shumë mbajtjen e këtij takimi si dhe përgëzojë gjithë grupin punues që ka punuar në hartimin e këtij draft dokumenti mirëpo kërkoj që të rritet përgjegjësia , menaxhimet të jetë më i afërt me punëtorët ,në mënyrë që organizimi i mirë i inkasimit e rritë performancën e kompanisë, si dhe a planifikohet në të ardhmen që kontejnerëve të bëhen me kode.

Zekë Kluna- Administrator i fsh.Poklek i vjetër – Theksoi se nuk ka ndonjë propozim konkret mirëpo që përgjegjësin për grumbullimin e mbeturinave bie edhe mbi ne qytetarët për mos vetëdijesim.

Rexhep Morina -Administrator i fsh. Fushticë e epërme- Kërkojë që të bë bëhet shpërndarja e kontejnerëve për ndarje të mbeturinave të bëhet edhe neper fshatrat tjera po ashtu edhe ne fshatin tone.

Kadri Ajazi – Administrator i fsh Sankoc- propozoi për planin komunal të menaxhimit të mbeturinave nuk patë ndonjë propozim konkret mirëpo theksoi që itinerari i grumbullimit të mbeturinave të zbatohet në ditët që janë të caktuara, pavarësisht mundësisë se hyrjes ne rrugët e lagjeve, andaj kompania të gjeje formën e grumbullimit në këto raste.

Pas dëgjimit së kërkesave të qytetarëve dhe kërkesave të tyre , u dhanë edhe përgjigjet nga drejtoresha e Shërbimeve Publike znj. Lumnije Krapit dhe shefi i sektorit z. Afrim Prokshi, në këtë rast drejtoresha theksoi se të gjitha shqetësimet e ngritura nga ana juaj janë të arsyeshme dhe do të merren në konsideratë, si dhe komuna do të ndërmarrë të gjitha masat se bashku në bashkëpunim me kompaninë që kryerja e shërbimeve në grumbullimin e mbeturinave të jetë sipas itinerarit të caktuar si dhe njëhërit do të bëhet edhe një riorganizim i këtij Itinerari në mënyrë që operimi i kompanisë të jetë më efektiv.

Kurse z.Prokshi u përgjigje edhe pyetjeve të parashtruara nga qytetarët duke theksuar se do të bëhet optimizmi i itinerarit të kryerjes së shërbimeve duke vendosur edhe GJPS në automjetet që operojnë në ‘KRM Pastrimi ‘ në mënyrë që të dihet saktë se në cilat fshatra do të kryhet grumbullimi mbeturinave, dhe këto janë të përfshira edhe në objektiven e parë të këtij draft plani , po ashtu z.Prokshi i'u përgjigje edhe znj.Shabani se është duke u bërë vetëdijesimi i qytetarëve ku në këtë rast janë krijuar grupet e gjelbëria në të gjitha shkollat të cilat janë duke luajtur një rol mjaft të rëndësishëm në vetëdijesimin e qyfterëve, po ashtu ritheksoi që është duke u bërë edhe kompostimi i i mbeturinave ku në këtë rast është bërë edhe ndarja e komposterëve si pilot projekti në zonat Drenas I ,Drenas II si dhe në Çikëtovë të re dhe pritet që të zgjerohet edhe në vendbanimet tjera sepse kjo është e paraparë edhe në draft planin e PKMM-së.

Takimin e mbylli udhëheqësi i takimit me publikun, Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, Bekim Dobra, duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje dhe për angazhimin në këtë tubim.

Konsultimi publik përfundoi në orën: 12:20

Janar, 2023



Përpiloi: Elira Zuçaku Morina